



PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më datë: **24.12.2024**, me fillim në orën **10:10**. Këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i Komitetit për Komunitete, **Bajram Morina**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Faleminderit për praninë tuaj! Përshëndetje për shefin e ZKKK-së, Lendrit Qelin, anëtarët e komitetit dhe gjithë të pranishmit! Ky është takimi i **gjashtë** dhe i fundit për vitin 2024. Për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i raportit vjetor nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, për vitin 2024;
3. Të ndryshme.

Kryesuesi: Atëherë, ky është rendi i ditës për sot. I kemi tri pika dhe po e vendosim në votim si të tillë. Kush është “për”?... Me shumicë unanime aprovohet rendi i ditës.

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Konstatohet që unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e dytë të cilën e ka Lendrit Qeli.

2. Shqyrtimi i raportit vjetor nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, për vitin 2024:

Lendrit Qeli: Të nderuar anëtarë të Komitetit për Komunitete! Raportin e kemi të publikuar edhe në faqen ueb të Komunës së Rahovecit. Do ta lexoj shkurtimisht. Raporti është i periudhës kohore janar-dhjetor 2024 dhe për fokus ka përmirësimin e kushteve për komunitetin joshumicë. Në arsim, në vazhdimësi kemi bërë fushata sensibilizuese me qëllim që fëmijët nga radhët e komunitetit joshumicë të regjistrohen me kohë në shkollë. Për këtë gjë falënderoj gjithashtu edhe pushtetin lokal, respektivisht Drejtorinë e Arsimit për fasilitimin, bashkëpunimin në këto fushata. Në sport, kemi ndërtuar terrenin sportiv në shkollën fillore “Gëzim Hamza”, meqë në këtë shkollë ka shumë nxënës të komunitetit joshumicë, si dhe në fshatin Dobidol e kemi ndërtuar një fushë sportive shumë të mirë. Në shëndetësi, janë duke ndodhur vizitat e shpeshta mjekësore, në bashkëpunim me organizatën “Balkan Sunflowers”, për vaksinim të fëmijëve dhe vizita të tjera mjekësore. Sa i përket kthimit dhe riatdhesimit, për këtë temë të rëndësishme deri më tani i kemi mbajtur 7 takime dhe i kemi shtjelluar të gjitha idetë dhe rastet që janë për t’u trajtuar. Raportin duhet ta lexoni sepse është mjaft voluminoz dhe gjithëpërfshirës sa i përket qëllimit tonë përreth komunitetit joshumicë.

Faton Ramadani: Faleminderit kryesues! Nevojat për komunitetet joshumicë janë të mëdha dhe konsideroj që përkrahja duhet të rritet më shumë.

Kryesuesi: Faleminderit Lendrit! A ka dikush diçka tjetër rreth raportit? Nëse jo, atëherë vazhdojmë me pikën e fundit.

3. Të ndryshme:

Skender Hamza: Në janar është plani i punës 2025. Kërkoj nga ju që të kontribuoni me ide dhe propozime në plan të punës, që i njëjti të jetë më voluminoz.

Faton Ramadani: Planin e punës duhet ta bëjmë me gjashtë mbledhje, apo më shumë se gjashtë?

Skender Hamza: Aty, ju si komitet e vendosni në bashkëpunim me kryesuesin e komitetit, ndoshta mund të jetë pak problem pagesat.

Faton Ramadani: Pse është problem pagesa?


Skender Hamza: Planin e punës mund ta bëni ashtu siç ju dëshironi, prej sekretarisë çdo pagesë që na vjen dërgohet në zyrën e Arjetës për ekzekutim.

Merisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë! Po e potencoj edhe një herë që të plotësohet plani i punës edhe me vizita në terren. Do ta kemi më të lehtë punën si komitet në tërësi.

Kryesuesi: Faleminderit, Merisë! Ju falënderoj të gjithëve për kontributin! Nëse nuk keni diçka tjetër për të shtuar, ju uroj festat e fundvitit dhe shihemi në mbledhjet e radhës!

Mbledhja përfundoi: 10:45

Procesmbajtësi:


Albion Krasniqi

Kryesuesi i mbledhjes:


Bajram Morina